

## **Abstrakti**

*Rritja në vazhdimësi e numrit të përdoruesve të drogave sikurse në Kosovë ashtu edhe në mbarë botën, tregon për dinamikën e rritjes së vëllimit të dukurisë së narkokriminalitetit në shoqërinë bashkëkohore. Këto janë informata shqetësuese, për shkak se shtimi i dukurive të tilla negative rrezikon ekonominë, sigurinë e shteteve të ndryshme, por edhe shëndetin dhe jetën e kategorive të caktuara të qytetarëve e në veçanti të të rinjve dhe fëmijëve, numri i viktimave të narkotikëve, nga radhët e të cilëve dita ditës është duke u rritur. Andaj është e natyrshme që ligjvënësi nacional sikurse i Kosovës, ashtu edhe i shteteve të regjionit siç është Shqipëria, Maqedonia, Malit i Zi dhe Kroacia, me norma penalo juridike e kanë rregulluar dhe sanksionuar veprimtarinë e tillë kriminale, që do të jetë çështje elaborimi e këtij studimi.*

*Krahas ligjvënësve, në luftë kundër narkokriminalitetit janë rreshtuar edhe organet proceduese duke filluar nga policia, prokurori i shtetit dhe gjykatat, të cilat ndërmarrin masa dhe veprime të ndryshme për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie. Në këtë përballje mjaft të suksesshme janë treguar masat operative taktike të policisë, qoftë në formë të kontrollimit kriminalistik, vëzhgimit, pritës, racisë apo masat e veçanta të hetimit në formë të përgjimit, ; hetimit të fshehtë; monitorimit të fshehtë të bisedave në vende publike etj. Po ashtu edhe analizimi dhe interpretimi i vendimeve të gjykatave lidhur me veprat penale të narkotikëve, është i një rëndësie të posaçme e në veçanti analizimit të llojeve dhe lartësisë së dënimeve, sepse përmes tyre përcaktohet politika ndëshkimore gjyqësore ndaj kryerësve të narkokriminalitetit.*

*Këto dhe çështje të tjera që ndërlidhen me dukurinë e narkomanisë dhe trafikimit me narkotikë do të hulumtohen dhe studiohen me metoda shkencore në kuadër të këtij punimi të masterit.*

**Fjalët kyçe:** trafikimi me narkotikë; narkomania; policia; etiologjia e narkokriminalitetit; fenomenologjia kriminale etj.

## ***Abstract***

*The continuous increase in the number of drug users, both in Kosovo and around the world, shows the dynamics of the increase in the volume of narco-criminality in contemporary society. This is disturbing information, because the increase of such negative phenomena endangers the economy, the security of different countries, but also the health and life of certain categories of citizens, especially young people and children, the number of victims of narcotics, from whose ranks are increasing day by day. Therefore, it is expected that the national legislature, such as that of Kosovo, as well as the states of the region, such as Albania, Macedonia, Montenegro and Croatia, have regulated and sanctioned such criminal activity with criminal law norms, which will be a matter of dealing with this study.*

*In addition to the legislators, in the fight against narco-criminality, the procedural bodies are aligned, starting with the police, the state prosecutor and the courts, which undertake various measures and actions to prevent and fight this phenomenon. In this confrontation, the operational tactical measures of the police have been shown to be quite successful, either in the form of criminal control, surveillance, host, race or special investigation measures in the form of wiretapping; secret investigation; secret monitoring of conversations in public places, etc. Likewise, the analysis and interpretation of court decisions related to narcotics offenses is of special importance, and in particular the analysis of the types and level of punishments, because through them the judicial punishment policy against perpetrators of narcocrime is determined.*

*These and other issues related to the phenomenon of drug addiction and drug trafficking will be researched and studied with scientific methods in the framework of this master's thesis.*

**Keywords:** drug trafficking; drug addiction; the police; the etiology of narcocriminality; criminal phenomenology etc.